



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERËVE**

---

Nr 1348 prot

Tiranë më 23.11.2016

**NJOFTIM**

**LIDHUR ME PROCEDURËN E ORGANIZIMIT DHE SHPALLJES SË  
REZULTATEVE TË PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT PËR MARRJEN E LEJES SË  
USHTRIMIT TE PROFESIONIT TË NOTERIT”**

Në zbatim të urdhërit nr. 7518/3, datë 23.11.2016 të Ministrit të Drejtësisë “Për caktimin e datës së konkurimit, kriteret dhe procedurën e organizimit dhe shpalljes së rezultateve të provimit të kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit te profesionit të noterit” si dhe ne baze te vendimit te Keshillit Kombetar date 23.11.2016, njoftojmë se Dhoma Kombëtare e Noterëve do të ndjekë procedurat e organizimit dhe shpalljes së rezultateve të provimit të kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit te profesionit të noterit si më poshtë;

1. Provimi i kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, për vendet vakante në njësitë e qeverisjes vendore, do të organizohet nga Dhoma Kombëtare e Noterëve në datën 18.12.2016, ora 09:00, në mjediset e Ministrisë së Drejtësisë.
2. Provimi i kualifikimit të zhvillohet për plotësimin e vendeve vakante për noterë, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur urdhërit nr. 7518/3, datë 23.11.2016 të Ministrit të Drejtësisë.
3. Çdo kërkesë për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit për noter të depozitohet pranë Dhomës Kombëtare të Noterëve. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës, që provon se kandidati përmbush kushtet për t'u bërë noter, sipas nenit 2, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, "Për noterin", i ndryshuar, si dhe me dokumentin që provon pagimin e tarifës së provimit.
4. Afati i fundit për depozitimin e kërkesave për pjesëmarrjen në provimin e kualifikimit është data 07.12.2016, ora 14:00.

5. Dhoma Kombëtare e Noterëve cakton Administratorët e Provimit dhe anëtarët e Komisionit të Kualifikimit të Provimit, jo më parë se data 18.12.2016.
6. Dhoma Kombëtare e Noterëve cakton anëtarët e Komisionit të Hartimit të Tezës, jo më parë se data 18.12.2016. Teza e provimit mbështetet në programin e përcaktuar në Aneksin 2 bashkëlidhur urdhërit nr. 7518/3, datë 23.11.2016 të Ministrit të Drejtësisë.
7. Dhoma Kombëtare e Noterëve cakton anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit për noter, jo më parë se data 07.12.2016.
8. Tarifa e provimit të jetë në vlerën 8000 (tetë mijë) lekë. Kandidati bën pagesën e shumës përpara dorëzimit të kërkesës, kundrejt faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Noterëve. Kjo pagesë mund të kryhet në një nga degët e bankave të Nivelit të Dytë. Një kopje të mandatit të pagesës kandidati e depoziton, së bashku me kërkesën për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit pranë Dhomës Kombëtare të Noterëve.
9. Pas përfundimit të shqyrtimit të të gjitha kërkesave brenda datës 10.12.2016, Komisioni për vlerësimin e kërkesave për pjesëmarrjen në provimin e kualifikimit për noter, depoziton për miratim pranë Dhomës Kombëtare të Noterëve listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet për t'u bërë noter, duke specifikuar edhe vendin vakant të kërkuar. Në të njëjtin afat, komisioni i vlerësimit të kërkesave dërgon për miratim tek Keshilli Kombëtar i Dhomes Kombëtare e Noterisë listën e kandidatëve të cilët nuk plotësojnë kushtet për t'u bërë noter, duke specifikuar arsyet dhe kushtet që nuk plotësohen .
10. Lista e kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provim publikohet në faqen zyrtare të Dhomes Kombëtare brenda datës 10.12.2016.
11. Kandidatët e skualifikuar për shkak të mosplotësimit të kushteve për t'u bërë noter kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë Dhomës Kombëtare të Noterëve brenda datës 14.12.2016 ora 14.00.
12. Dhoma Kombëtare e Noterëve, shqyrton ankimet dhe shkaqet e parashtruara nga komisioni përkatës dhe vendos mbi ankimet brenda datës 15.12.2016. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha ankimeve, brenda datës 15.12.2016, Dhoma Kombëtare e Noterëve miraton listën përfundimtare të kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit për të ushtruar profesionin e noterit. Kjo listë publikohet në faqen zyrtare të Dhomes Kombëtare të Noterëve.
13. Kandidatët e kualifikuar për pjesëmarrje në provim të paraqiten më datë 18.12.2016, ora 09:00 në Ministrinë e Drejtësisë me dokument identifikimi (kartë identiteti ose

pasaportë të vlefshme). Nuk lejohet hyrja e kandidatit në sallën e provimit, kur kandidati mban çantë, dosje, mjete elektronike ose telefonike.

14. Kandidati hyn në sallën e provimit vetëm me dokumentin e identitetit. Çdo material tjetër lihet në ruajtje në një mjedis të posaçëm në Ministrinë e Drejtësisë, nga punonjësit me uniformë. Sendet e lëna në ruajtje i kthehen kandidatit menjëherë pas përfundimit të provimit.
15. Pasi kandidati njihet me rregullat e provimit, nënshkruan deklaratën se i njeh dhe i pranon këto rregulla dhe se është i ndërgjegjshëm që shkelja e tyre, sjell skualifikimin e menjëhershëm nga provimi. Administratorët e Provimit bëjnë mbledhjen e deklaratave, duke u siguruar se ato janë nënshkruar rregullisht nga kandidatët. Mos nënshkrimi i deklaratës përbën shkak për skualifikimin e menjëhershëm të kandidatit.
16. Pas mbledhjes së deklaratave, Administratorët e Provimit, njoftojnë punonjësin me uniformë, i cili është personi i autorizuar për të tërhequr pranë Komisionit të Hartimit të Tezës, Tezën e Provimit. Punonjësi me uniformë, merr në dorëzim tezën e provimit dhe ia dorëzon atë Administratorëve të Provimit, të cilët pasi sigurohen se zarfi është i mbyllur bëjnë hapjen e tij dhe në prani të kandidatëve vijnë me procesin e shumëfishimit të tezës së provimit.
17. Pas përfundimit të procesit të shumëfishimit, Administratorët e Provimit bëjnë shpërndarjen e tezës së provimit, duke njoftuar orën e fillimit dhe të përfundimit të provimit. Pas shpërndarjes së tezës së provimit kryhet edhe procedura e sekretimit të fletës së provimit nga një person i autorizuar për këtë qëllim nga Dhoma Kombëtare e Noterëve.
18. Rezultatet e provimit afishohen brenda tre ditëve nga data e zhvillimit të provimit, në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Noterëve. Pas kësaj date, kandidatët mund të kërkojnë të njihen me rezultatet individuale të provimit, nëpërmjet adresës elektronike që do të njoftohet në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Noterëve.

**KRYETARE E DHOMËS KOMBËTARE**

**MIMOZA SADUSHAJ**

